



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272696

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05476869

**C-IV-14-5037**

*Ankuesi*

**H B**, Prishtinë.

**Kundër:**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 20 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. APROVOHET** ankesa si pjesërisht e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN093-0293 datë 27 qershor 2014.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **H B** në emër të kompensimit për asistencën sociale për periudhën prej 01 janar 2005 – 14 gusht 2007, t’i paguaj **shumën prej 600.00 €** dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 60.00 €**, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës prej **975.00 €**, përtej shumës së aprovuar refuzohet.
- 3.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **20.00 €**.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 02 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN093-0293, të datës 27 qershor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale nga NSH “Gërmia” (në likuidim). Ankuesi theksoi se AL i AKP-së me vendimin e vet ia ka refuzuar kërkesën për pagesë të pagave të papaguara të asistencës sociale nga marrëdhënia e punës në shumë prej 1,575.00 €. Kjo asistencë sociale e lejuar nga NSH “Gërmia” sipas vendimit nr. 622 datë 06

qershor 2001 dhe në rastin e hapjes së procedurës së privatizimit me likuidim të thjeshtë, me kohë këtë kërkesë e ka parashtruar te ky AL, mirëpo kjo kërkesë u refuzua dhe i pakënaqur me këtë në afatin e lejuar ai ushtroi këtë ankesë. Ankuesi më tej pohoi se vendimi i AKP-së – AL është i pabazuar dhe i kundërligjshëm. Në arsyetimin e vendimit të ankimuar, me të cilin është refuzuar kërkesa e tij për pagesë të mjeteve të lejuara me vendimin për asistencë sociale të NSH-së në shumë prej 1,575.00 €, ndër të tjera thuhet: Se kërkesa është regjistruar në AKP me datë 02 tetor 2007, që është brenda afatit të paraparë të dorëzimit të kërkesave (25 tetor 2007). AL me 08 maj 2014 i ka kërkuar ankuesit që të dorëzoj dokumente shtesë të cilës ankuesi i është përgjigjur me 21 maj 2014. Ankuesi e ka vendimin për lejimin e asistencës sociale, të cilin me kohë e ka dërguar në AKP, në të cilin thuhet se ankuesi mbetet përkohësisht i/e pa angazhuar në punë dhe se i njëjti nga kjo datë është në asistencë sociale. Ankuesi njoftoi se NSH-ja deri në kohën kur ka shkuar në procedurë të likuidimit me 25 korrik 2007 ka marrë mjete në të holla nga qiratë e lokaleve të cilat i kanë pas të dhëna me qira. Ky fakt nuk është kontestues. Andaj baza ligjore për pagesën e asistencës sociale të ankuesit të kërkesës ekziston, sepse ato mjete të cilat i kërkon janë të qirave të cilat NSH-ja i ka lëshuar me qira lokalet e ndërmarrjes. Ankuesi në afatin ligjor ka bërë kërkesë për pagimin e asistencës sociale në shumë prej 50.00 € në muaj. Prandaj nga se u tha më lartë shihet se gjendja faktike e vërtetuar me vendimin e ankimuar është plotësisht e gabuar dhe jo e plotë. Ankuesi i propozon gjykatës që të aprovet ankesa e tij si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që t’ia paguaj shumën prej 1,575.00 € të papaguar në emër të asistencës sociale, me kamatë ligjore si dhe t’ia paguaj shpenzimet e kësaj procedure kontestimore sipas vendimit të kësaj gjykate. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Vendimin e kundërshtuar, Vendimin e përkohshëm të asistencës sociale nr. 622 datë 06 qershor 2001, Formularin e kërkesës për likuidim REF L25 datë 02 tetor 2007, Vërtetimin e lëshuar nga NSH “Gërmia” nr. 542 datë 14 prill 2003, Njoftimin e lëshuar nga AKP lidhur me kërkesën për informata apo dëshmi shtesë për ankuesin datë 08 maj 2014 dhe Kopjen e letërnjoftimit.

Me 16 janar 2024 gjykata lëshoi urdhër për ankuesin ku ndër të tjera nga i njëjti kërkoi që të dorëzonte prova relevante shtesë. Me 29 janar 2024, ankuesi dorëzoi një përgjigje në urdhrin e gjykatës me propozim që ankesa e tij të aprovet. Në mbështetje të përgjigjes së tij ankuesi dorëzoi Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 14 gusht 2007 si dhe ri dorëzoi dëshmitë të cilat i kishte dorëzuar me ankesë.

Me 26 shkurt 2024, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se në marrjen e vendimit mbi kërkesën e ankuesit AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike përcjellë nga një zbatim i saktë i dispozitave të zbatueshme ligjore. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesa e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimit të AL duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në

pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. Neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parashikon “ *elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë... dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar, mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese*”. Bazuar në dispozitat e mësipërme, kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve, nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Prandaj, ky AL vendosi që të refuzojë këtë kërkesë si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur vetëm Vendimin e kundërshtuar.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga pohimet e palëve dhe shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN093-0293, datë 27 qershor 2014, me të cilin vendim, edhe pas kërkesës për dëshmi

dhe informacione shtesë ishte refuzuar në mungesë të provave kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale në shumë prej 1,575.00 € për periudhën kohore prej 1 janar 2005 – 14 gusht 2007 nga NSH “Gërmia” (në likuidim).

Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: Formularin e kërkesës për likuidim ref. L25 datë 17 tetor 2007, Vendimin e përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale të lëshuar nga NSH “Gërmia” nr. 622 datë 06 qershor 2001 dhe Listën e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005; faqe 1-9, (Listë e cila është dorëzuar në disa lëndë të kësaj natyre që janë në shqyrtim në gjykatë si: C-IV-14-4965, C-IV-14-6120, C-IV-14-6448, etj.) si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga njoftimi për përfundimin e punësimit datë 14 gusht 2007, i dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “Gërmia” deri me 14 gusht 2007, kohë edhe kur shumica (apo të gjitha) asetet e NSH-së janë shitur dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit ka pushuar.

Nga lista e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005, vërtetohet fakti se ankuesi kishte statusin e punonjësit në asistencë sociale dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit shumë bruto prej 600.00 € në emër të asistencës sociale për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2005 (nr. rendor 264). Andaj, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e ankuesit pra shumë prej 600.00 €, duke u bazuar në dëshmitë e lartcekura e veçanërisht duke ia falur besimin listës së punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës në mungesë të dëshmive e refuzon.

Gjykata pasi ka shqyrtuar në tërësi të gjitha dëshmitë e dorëzuara në këtë rast në lidhje me kërkesën për kompensim të asistencës sociale për periudhën objekt kontesti, ka gjetur se pjesa tjetër e kërkesës në shumë prej 975.00 €, për periudhën 1 janar 2006 – 14 gusht 2007, nuk është e mbështetur në prova dhe dëshmi relevante. Siç ka arsyetuar edhe e paditura në mbrojtjen e saj, ankuesi kishte dështuar të dorëzonte prova dhe dëshmi relevante edhe në procedurën e likuidimit kur ishte shqyrtuar kërkesa e tij kreditore nga AL.

Andaj, gjykata vie në përfundim se meqenëse ankuesi kishte statusin e punonjësit në asistencë sociale tek NSH-ja dhe se ka pjesërisht dëshmi se NSH i kishte mbetur borxh kompensimin për periudhën e lartcekur, kështu i takon e drejta në kompensim të mjeteve të asistencës sociale, në shumë e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me këto raste dhe këtë NSH (AC-I-22-0320, AC-I-22-0465, etj.).

Gjykata e aprovon shumë në lartësi prej 60.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore për ankesë në shumë prej 20.00 €.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar